



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT

MODULI: Trashëgimia Kulturore

Tiranë, 2016



PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	Trashëgimia kulturore
Qëllimi i modulit	Aftësimi i nxënësve në njohjen dhe përvetësimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të krijuara në shekuj nga populli ynë dhe popujt e tjerë të botës. Zhvillimi i modulit ndihmon fuqimisht formimin dhe edukimin qytetar të brezit të ri, i cili duhet të njohë, të respektojë, mbrojë dhe të pasurojë vazhdimisht vlerat më të spikatura të kulturës së vendit të tij dhe të vendeve të tjera në botë.
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore
Rezultatet e të nxënit (RN), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi analizon konceptin e trashëgimisë kulturore (3 orë). Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Tipologjitë e trashëgimisë kulturore materiale.- Qendrat e trashëgimisë kulturore kombëtare në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.- Trashëgimia Kulturore Materiale: Monumentet e kulturës, qendrat historike, parqet dhe zonat arkeologjike, muzetë, objekte të kultit monument kulture, ndërtimet popullore, objekteve etnografike, etj.- Lista e Trashëgimisë Botërore UNESCO.- Monumentet kryesore të trashëgimisë kulturore evropiane dhe botërore.- Vëzhgime dhe interpretime të monumenteve të dukurive të trashëgimisë kulturore në qytetin/fshatin apo zonën ku jeton. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Të identifikojë lëndën e trashëgimisë kulturore si lënda që studion vlerat kulturore materiale dhe ato shpirtërore të krijuara nga njeriu përgjatë gjithë historisë së ekzistencës së tij.- Të identifikojë dhe shpjegojë monumentet kryesore të trashëgiminë kulturore evropiane dhe botërore.- Të shpjegojë domosdoshmërinë e lidhjes mes vlerave të trashëgimisë kulturore dhe kujdesit për ruajtjen e tyre deri në ditët tona.- Të vizitojë disa prej monumenteve të trashëgimisë kulturore.

RN2 Nxënësi analizon veçoritë e trashëgimisë kulturore materiale kombëtare dhe më gjerë (12 orë).

Përmbajtja:

- Tipologjitë e trashëgimisë kulturore materiale.
- Trashëgimia Kulturore Materiale: Monumentet e kulturës, qendrat historike, parqet dhe zonat arkeologjike, muzetë, objektet e kultit monument kulture, ndërtimet popullore, objekteve etnografike, etj.
- UNESCO, Qendra e Trashëgimisë Botërore dhe Lista e Trashëgimisë Botërore.
- Monumentet kryesore të trashëgimisë kulturore evropiane dhe botërore.
- Vëzhgime dhe përshkrime të monumenteve të kulturës në qytetin/fshatin apo zonën ku jeton.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përkufizojë përmbajtjen e termit trashëgimi kulturore materiale.
- të identifikojë tipologjitë kryesore të trashëgimisë kulturore materiale.
- të dallojë kriteret e klasifikimit të trashëgimisë kulturore materiale.
- të dallojë vlerat historike, artistike dhe të traditës të monumentit të kulturës.
- të identifikojë elementet kryesore të spikatur të listës botërore të monumenteve të kulturës dhe shpërndarjen gjeografike të tyre.
- Të njohë Listën e Qendrave të Trashëgimisë Botërore natyrore dhe kulturore dhe të identifikojë disa nga qendrat më të spikatura të rajonit të Evropës të regjistruara në këtë listë.
- të identifikojë qendrat kryesore historike të qyteteve evropiane, pjesë e “World Heritage list”, UNESCO, dhe të shpjegojë rëndësinë e qendrave historike të qyteteve evropiane.
- të përshkruajë vlerat arkitekturore të disa qyteteve të vjetra dhe qendrave historike të Evropës dhe Botës.
- të identifikojë monumentet të kulturës shqiptare në listën e trashëgimisë botërore, si Butrint – 1992, Qendrat historike të Gjirokastrës dhe Beratit.
- të identifikojë shpërndarjen gjeografike të qendrave historike në vendin tonë.
- të përshkruajë veçoritë e kalave dhe kështjellave në vendin

- tonë, pasi të ketë vizituar një ose disa prej tyre.
- të përshkruajë veçoritë kryesore të parqeve kombëtare arkeologjike dhe rëndësinë e tyre në kontekstin e zhvillimit dhe promovimit të turizmit kulturor.
 - të përshkruajë veçoritë kryesore të objekteve të kultit të shpallura monument kulture dhe të dallojë tipologjitë e tyre.
 - të përcaktojë llojet e ndërtimeve popullore si kategori e rëndësishme e monumenteve të kulturës.
 - të dallojë larminë dhe vlerat e objekteve etnografike në kuadrin e trashëgimisë kulturore.
 - të vizitojë një monument të kulturës (monumentet e kulturës, parqet arkeologjike, kalatë, etj) në qytetin/fshatin apo zonën ku jeton.
 - të vëzhgojë nga afër dhe të përshkruajë një ose disa kostume popullore të qytetit/fshatit apo zonës ku jeton si objekte etnografike të trashëgimisë kulturore.
 - të identifikojë institucionet e trashëgimisë kulturore materiale.
 - të përshkruajë procesin e katalogimit të trashëgimisë kulturore si informacioni, ruajtja dhe studimi.
 - të ndajë objekte kulturore materiale të sjella nga shtëpia (fotografi, objekte të vjetra, veshje) sipas llojit të dokumentit.

RN3 Nxënësi analizon veçoritë e trashëgimisë kulturore jomateriale kombëtare dhe më gjerë (9 orë).

Përmbajtja:

- Trashëgimia jomateriale dhe tipologjitë e saj.
- Lista botërore e kryeveprave të trashëgimisë gojore dhe shpirtërore.
- Monumentet e trashëgimisë kulturore jomateriale në Republikën e Shqipërisë.
- Lista e kryeveprave të trashëgimisë kulturore jomateriale shqiptare.
- Iso-polifonia popullore shqiptare si dukuri unike e shumëzëshit popullor tradicional botëror.
- Folklori vokal, folklori muzikor instrumental dhe veglat muzikore popullore.
- Përrallat dhe legjendat në trashëgiminë kulturore jomateriale.
- Lojërat dhe ritet si elementë të trashëgimisë kulturore jomateriale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të identifikojë përmbajtjen dhe strukturën e trashëgimisë shpirtërore.
- të dallojë tipologjitë kryesore të trashëgimisë shpirtërore.
- të emërtojë kryeveprat e trashëgimisë kulturore jomateriale në një vështrim botëror.
- të tregojë kriteret e përfshirjes e kryeveprave në listën botërore.
- të rendisë nga lista botërore e kryeveprave të trashëgimisë gojore dhe shpirtërore disa prej tyre.
- të dallojë monumentet e trashëgimisë kulturore shpirtërore në Republikën e Shqipërisë.
- të përshkruajë vlerat e Iso-polifonisë popullore shqiptare si dukuri unike e shumëzëshit popullor tradicional botëror.
- të vlerësojë vendin e iso-polifonisë në trashëgiminë botërore.
- të dallojë karakteristikat bazë të muzikës popullore homofonike.
- të përshkruajë folklorin vokal, folklorin muzikor instrumental dhe veglat muzikore popullore.
- të dëgjojë dhe këndojë këngë të folklorit muzikor nëpërmjet (regjistrimeve në CD, vegla muzikore tradicionale).
- të dallojë llojet dhe karakteristikat e vallëzimit popullor.
- të intervistojë personalitete të shquar të trashëgimisë kulturore, bartës dhe interpretues të folklorit muzikor shqiptar si dhe piktorë, muzikantë, gjuhëtarë dhe instrumentistë.
- të hartojë dhe zhvillojë një projekt që ndihmon ndërgjegjësimin e të rinjve për përpjekjet në mbrojtje të trashëgimisë jomateriale.
- Të organizojë aktivitete dhe të jetë pjesëmarrës në ditët kombëtare dhe evropiane të kulturës.

RN 4 Nxënësi analizon vlerat e turizmit kulturor referuar trashëgimisë kulturore (7 orë).

Përmbajtja:

- Turizmi kulturor.
- Tradita botërore në fushën e turizmit kulturor.
- Marrëdhëniet dhe vlerat mes trashëgimisë kulturore dhe turizmit kulturor.
- Veçoritë e turizmit kulturor në vendin tonë.
- Qendrat/institucionet e trashëgimisë kulturore më të

- vizituara në vendin tonë.
- Gastronomia dhe vlerat e saj.
- Artizanatet dhe punimet artizanale në vendin tonë.
- Eventet kryesore të trashëgimisë kulturore jomateriale (Festivali Folklorik i Gjirokastrës, Festivalet Tipologjike, Muzetë Etnografikë).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përkufizojë se ç'është turizmi kulturor.
- të vlerësojë traditën botërore në fushën e turizmit kulturor.
- të përshkruajë turizmin si mjet të komunikimit ndërkulturor.
- të klasifikojë veçoritë, vlerat e marrëdhëniet mes trashëgimisë kulturore dhe turizmit kulturor.
- të përshkruajë veçoritë e turizmit kulturor në vendin tonë.
- të vlerësojë rëndësinë e turizmit kulturor.
- të identifikojë qendrat e trashëgimisë kulturore më të vizituara në vendin tonë.
- të përshkruajë veçoritë gastronomike në vendin tonë.
- të përshkruajë disa prej artizanateve të ushtruara në vendin tonë.
- të identifikojë disa lloje punimesh artizanale.
- të realizojë në grup një guidë turistike të qytetit apo fshatit ku jeton.
- të përshkruajë një tregim/legjendë/përrallë nga fshati/qyteti/zona ku jeton.
- të dallojë dhe përshkruajë kostumin tradicional të fshatit/qytetit/zonës ku jeton, të njohë elementët e tij
- të interpretojë një element të trashëgimisë kulturore jomateriale vokal, instrumental, koreografik etj.
- të vlerësojë eventet kryesore të trashëgimisë kulturore jomateriale.

RN5 Nxënësi përshkruan dhe analizon legjislacionin për trashëgiminë kulturore (5 orë).

Përmbajtja:

- Konventa e UNESCO-s për Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore dhe Konventa të tjera të UNESCO dhe KiE për trashëgiminë kulturore materiale.
- Legjislacioni shqiptar mbi trashëgiminë kulturore.
- UNESCO-s si institucion ndërkombëtar përgjegjës për

promovimin e kulturës, trashëgimisë kulturore dhe të edukimit.

- Konventa e UNESCO-s për mbrojtjen e Trashëgimisë kulturore jomateriale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të njohë Konventën e UNESCO-s për Trashëgiminë Kulturore, përmbajtjen, strukturën dhe institucionet e saj; detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga të qenit shtet palë në këtë konvente.
- të njohë parimet bazë të legjislacionit shqiptar lidhur me trashëgiminë kulturore.
- të vlerësojë masat lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe popullarizimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.
- të përshkruajë organizimin dhe rolin e institucionit të UNESCO-s si institucion ndërkombëtar përgjegjës për promovimin e kulturës, trashëgimisë kulturore dhe të edukimit në gjithë botën.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Për realizimin e modulit, nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e detyrave, punëve individuale dhe në grup. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me rëndësinë trashëgimisë kulturore kombëtare, Europiane dhe botërore.
- Për arritjen e rezultateve të parashikuara mund të programohen vizita pranë monumenteve të kulturës, muzeve, parqeve arkeologjike, natyrore, etj. si dhe organizimi pranë tyre të orëve/veprimtarive mësimore me tematika të ndryshme.
- Nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike (si p.sh. të përgatisë një detyrë tematike mbi detyrimet që dalin nga zbatimi i legjislacionit shqiptar në lidhje me trashëgiminë kulturore) projekte kurrikulare (si p.sh. të realizojë individualisht ose në grup një projekt mbi monumente të trashëgimisë materiale dhe/ose shpirtërore përmes të cilit nxënësit identifikojnë vlerat e pasurive kulturore kombëtare).

-
- Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) duhet t'i shërbejë jo vetëm përfundimit të informacioneve të nevojshme në lidhje me trashëgiminë kulturore, por dhe ndërveprimin aktiv të nxënësve midis tyre dhe me mësuesi/en për të shkëmbyer ide, argumente, për të realizuar detyra dhe prezantime të ndryshme.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te vlerësimi i shkallës së zhvillimit të njohurive dhe shkathtësive të nxënësve, të parashikuara në modul. Mësuesi zhvillon vetë e ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Portofoli i nxënës/it,-es, sugjerohet si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi si dhe informacioni të prindërit për progresin e nxënësit.